

Kristi KABA

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

ERA DIGJITALE NË LËMIN E ARKIVISTIKËS

Përmbledhje: Për ta rrokur rëndësinë e digjitalizimit të materialeve arkivore, nevojitet, pikësëpari, kuptimi i qëllimit të këtij procesi që ka revolucionarizuar qasjen e publikut në dokumentacione. Për këtë arsye, në saje të thellimit në literaturë, me këtë punim të ndarë në dy kapituj, kryejmë fillimisht një analizë të përparësive që ka mundësuar digjitalizimi, si forma më bashkëkohore e për qasje në pasuritë arkivore.

Mandej, për t'i dhënë trajtesës karakter empirik, do t'i kushtohet një hapësirë e posaçme shqyrtimit të filozofisë së re të ndërveprimit që ka adaptuar përfitim kompjuterik i informacionit mes qytetarit/studiuesit dhe institucionit që ruan dhe vë në gatishmëri arsenalin dokumentar. Ky kapërcim prej teorisë në rrafshin praktik do të konkretizohet duke marrë në konsideratë tërësinë prej rreth 2000 studiuesish, duke i bashkëngjitur grupmoshën së cilës i përket sekush prej tyre, të regjistruar në Sallën e Studimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA) që prej janarit të vitit 2019, kohë që shënon pikën e kthesës në drejtim të shfrytëzimit të pasurisë dokumentare.

Në vazhden e zhvillimit teknologjik në disiplina të shumta, shpejtësia, cilësia e lartë imazherike dhe disponueshmëria e menjëhershme, janë bërë pjesë edhe e leksikonit të arkivistikës të këtij shekulli. Krahas këtyre tipareve të lartpërmendura, digjitalizimi synon, mbi të gjitha, të sigurojë jetëgjatësinë dhe pacenueshmërinë maksimale të integritetit fizik të dokumenteve të hershme. Në këtë fushëpamje në kreun e parë do të nxirret në pah se nëpërmjet diversifikimit të kanaleve të transmetimit të materialeve, është impaktuar ecuria e punës kërkimore.

Sakaq, piku i epokës digjitale ka ridimensionuar predispozitën e publikut për të hulumtuar. Në pjesën e fundit të këtij punimi do t'i referohemi një qëmtimi të hollësishëm që synon të evidentojë përmes shifrave të konvertuara në përqindje, peshën që zë secila prej kategorive moshore në frekuentimin e Sallës së Studimit të DPA-së, pikënisje e nevojshme për të konkluduar më pas në formën e një sinteze, ndër të tjera, mbi aftësinë adaptuese të qytetarëve/studiuesve me mënyrën e re të shqyrtimit të dokumentacioneve. Kësodore, në saje të këtij pasqyrimi, do të mund të arrihet edhe në konfigurimin e projeksioneve në terma afatmesëm, që parashohin bazuar në të dhënat aktuale, trendin e bashkësisë së shqyrtuesve të përmbajtjeve arkivore, që priren kah formës digjitale të përfitimt të informacionit.

Abstract: To grasp the importance of digitalizing archival materials, it is necessary to understand the purpose of this process that has revolutionized the public's access to documentation. For this reason, thanks to the deepening in the literature, this paper, divided into two chapters, first performs an analysis of the advantages that

digitalization has enabled, as the most contemporary form of access to archival property.

Then, in order to guarantee an empirical view, a special space will be devoted to the examination of the new philosophy of interaction adapted by the computer use of information between the citizen / researcher and the institution that preserves and puts the documentary arsenal on standby. In terms of practice, will be considered a study addressed to a sample of 2000 researchers ordering or reviewing archival content in digital form, registered in the Study Room of the General Directorate of Archives (DPA), since January 2019, time that marks the turning point in the use of documentation.

In the course of technological development in many disciplines, speed, high image quality and immediate availability, have become part of the lexicon of archivism of this century. In addition to the above-mentioned features, digitalization aims above all to ensure maximum longevity and inviolability of the physical integrity of early documents. In this view, in the first chapter it will be pointed out that through the diversification of material transmission channels, the progress of research work has been impacted.

Meanwhile, the peak of the digital age has redimensioned the public's predisposition to research. In the final chapter of this paper, we will refer to a detailed survey that seeks to measure the adaptive ability of citizens / researchers of different age groups with the new way of examining documentation. This sample is based on the registrations lists of the Study Room in the General Directorate of Archives, which is the national Archive of the Republic of Albania. Thus, a conclusion can be reached regarding the subject matter of this topic: the trend of the community of reviewers of archival content, which tend towards the digital form of obtaining information.

I. Procesi inovativ i digjitalizimit të Sallës së Studimit

I.1. Digjitalizimi i trashëgimisë historike

Veprimtaria e një institucioni arkivor, sikurse është Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA), konsiston në mbledhjen, përpunimin, sistemimin, mirëmbajtjen dhe vënien në gatishmëri për publikun të materialeve dokumentare joaktuale, të përcaktuara të kenë vlerë të përhershme ose të përkohshme ruajtjeje. Për analogji me objektet muzeale, materialet arkivore bëjnë pjesë në korpusin e trashëgimisë historike të një vendi, që shënjon kujtesën e shoqërisë së tij për gjenerata të tëra. “Këto institucione të trashëgimisë historike dhe kulturore (muzetë dhe arkivat) përpiqen të edukojnë, të promovojnë dhe të kujtojnë të kaluarën përmes mbledhjes, menaxhimit dhe prezantimit të objekteve dhe zakoneve të vendeve dhe shoqërive të ndryshme”.¹

¹ Genevieve A. Horan, *Digital Heritage: Digitization of Museum and Archival Collections*, Research papers (2013), f. 1.

Ekspozimi publik i kësaj trashëgimie historike ka shërbyer prej motesh si miklim për një audiencë me një denduri të theksuar studiuesish, që janë rrekur të thellohen në hulumtim mbi subjekte të larmishme. “Brenda koleksioneve të gjera të institucioneve muzeore dhe arkivore kuratorët, studiuesit dhe arsimtarët janë në gjendje t’i zgjerojnë njohuritë e tyre përmes hulumtimit të burimeve parësore që gjenden në këto institucione, qofshin ato objekte, artefakte dhe/ose ekzemplarët dhe dokumentet e tyre përkatëse”.² Deri vonë pikëtakimi i vetëm me koleksionet arkivore të shtetit shqiptar mundësohej përmes vizitave fizike në Sallën e Studimit të DPA-së. “Arkivat nisën shërbimin si hapësira fizike për të grumbulluar dokumente dhe regjistrime historike të burimit parësor që duhen mbajtur me kalimin e kohës”.³ Mirëpo, ardhja e epokës digjitale ka diversifikuar sinergjinë në raportin institucion-publik, duke ndikuar pa kthim në të ardhmen e metodave të administrimit të pasurisë arkivore. “Trashëgimia historike e digjitalizuar përfshin materiale të bazuara në kompjuter me vlerë të qëndrueshme që duhen ruajtur për brezat e ardhshëm”.⁴

Salla e Studimit e DPA-së, e cila numëron një vit e gjashtë muaj prej nisjes së procesit të digjitalizimit, shërben si një shembull mjaft i pëlqyeshëm për të kuptuar dhe shpjeguar format novatore të hulumtimit në dokumentacione, qoftë për qëllime individuale e qoftë për interesa studimore. Sikurse nënkupton vetë emërtesa, Salla e Studimit e DPA-së vë në shfrytëzim për studiuesit fonde personale, inventarë, katalogë dhe skedarë që shërbejnë si udhëzues drejt përmbajtjes së dokumenteve arkivore me prapavijë historike në rend kronologjik dhe tematik. Përkatësisht, mund të sigurohen informacione në lidhje me angazhimin e personaliteteve të ndryshme me ndikim në jetën shoqërore dhe politike të vendit, apo që pasqyrojnë veprimtarinë disadisciplinore të periudhës parashtetërore, si edhe të institucioneve qendrore e lokale në disa intervale vjetore, që me shpalljen e pavarësisë së vendit, pas piketës kohore të vitit 1912 e deri në çlirimin nga pushtuesit nazifashistë në vitin 1944, për të kaluar më pas në periudhën 45-vjeçare të totalitarizmit deri në Shqipërinë porsademokratike të viteve ’90. Inventarët e vitit 1995 janë rishtazi pjesë e tërësisë së materialeve arkivore, për arsye se pas përmbushjes së afatit të maturimit prej 25-vjetësh, janë vënë në shfrytëzim të studiuesve që prej janarit të sivjetshëm.

Nuk është e nevojshme që kjo tablo të përfytyrohet, pasi ndarja mes kategorive të lartpërmendura gjendet e konkretizuar në një “trase” të faqes

² Horan, *Digitization of Museum and Archival Collections*, f. 12.

³ Alexander, Edward P. dhe Alexander, Mary, *Museums in Motion* (New York: Alta Mira Press, 2008), f. 15.

⁴ UNESCO, *Concept of Digital Heritage*, shikuar më dt. 02.06.2020 në: <http://www.unesco.org/new/en/communication-and-information/access-to-knowledge/preservation-of-documentary-heritage/digital-heritage/concept-of-digital-heritage/>.

zyrtare të DPA-së, “Katalogu online”, ku përvijohet dora-dorës një pemë e kërkimit arkivor me degëzimet e fondeve të Arkivit Qendror të Shtetit (AQSh). Pra, në pamundësi për ta vizituar fizikisht Sallën e Studimit, veçanërisht e rëndësishme për shqiptarët e këtejkuqurit të disavantazuar për arsye logjistike, por edhe për bashkëkombësit e përtejkuqurit, ofrohet një mundësi e barasvlershme për t’u thelluar mbi dokumentacione edhe në rrugë virtuale. Sa më sipër, është thjesht një fraksion i procesit inovativ të digjitalizimit, që do të shpaloset në mënyrë shteruese në të gjithë spektrin e tij në nënkrerët që vijojnë.

1.2. Qasja e publikut në dokumentacione

Arkivat digjitale iu referohen materialeve arkivore që janë shndërruar përmes makinerive adekuate në format elektronik për të siguruar, mbi të gjitha, jetëgjatësinë optimale të dokumentacionit disponues dhe për ta lehtësuar qasjen e audiencës, e cila nga pikëpamja numerike është rritur ndjeshëm në saje të automatizimit - më shpejt dhe më lehtë. Digjitalizimi në një mjedis arkivor përfshin marrjen e objekteve analoge, që identifikohen kryesisht me dosje fizike (përfshirë edhe materialet fotografike të sektorit të Fototekës), të cilat mund të jenë edhe pjesë e një koleksioni të rrallë dhe unik, shpesh jashtëzakonisht të brishtë dhe të dëmtuar nga vjetërsia, skanimin e tyre dhe transferimin e kësaj përmbajtjeje digjitale në një medium kompjuterik. Dosjet ose përmbajtjet tanimë digjitale importohen dhe menaxhohen përmes programeve softuerike. “Këto dosje mund të lexohen, kompresohen, transferohen dhe merren përmes rrjeteve kompjuterike dhe pastaj bëhen të arritshme dhe shfletohen në monitorët e kompjuterëve. Produkti përfundimtar përcaktohet nga sa mirë janë kryer këto funksione”.⁵

Duke mbetur në domenin e digjitalizimit, që është kryefjala e këtij punimi, do të ndalemi te procedura e porositjes së dosjeve të listuara nga studiuesit, pas shfletimit dhe konsultimit me inventarët, skedarët dhe katalogët e disponueshëm në Sallën e Studimit. Me t’u regjistruar në Zyrën e Informacionit apo në faqen zyrtare të DPA-së, studiuesi pajiset me një kartë shumëfunktionale, që do t’i nevojitet fillimisht për të hyrë në Sallën e Studimit dhe më tej për ta kryer porositjen e materialeve të evidentuara në listë me referencat arkivore përkatëse: kategori/emërtim i fondit, vit dhe numër i dosjes. Përmes kësaj karte që vendoset në një lexues përbri kompjuterëve personalë, do të mundësohet edhe qasja ndaj dosjeve të porositura të skanuara, që mund edhe të printohen, pjesërisht ose plotësisht, sipas përzgjedhjes së studiuesit. Hapi i radhës është klikimi mbi ikonën e komandës “Shto” për secilën prej porosive që mund të arrijnë maksimalisht

⁵ Teresa Beamsley, *Securing digital image assets in museums and libraries: A risk management approach*, *Library Trends* (1999), f. 364.

deri në sasinë e 25 dosjeve. Mandej mbetet për t'u përzgjedhur forma më e volitshme e qasjes mes alternativave "Porosit falas për Sallën e Studimit", që na vendos përpara një kalendari me datat e hapura të disponueshme dhe opsionit "Bli on-line", komandë që për finalizim kërkon numrin e një karte krediti, për të përfutur materialet në mënyrë elektronike, pa qenë e nevojshme paraqitja në Sallë.

1.3. Dobitë e arkivimit digjital

Afërmendsh, arkivimi digjital përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit mundëson që informacionet arkivore të arrihen kudo, në çdo kohë dhe nga kushdo që ka nevojë për to. Ky është pikërisht qëllimi përfundimtar i konservimit arkivor: ruajtja e materialeve me vlerë të qëndrueshme për hir të brezave të ardhshëm. Sikurse u përmend më herët në këtë trajtesë, përparësia më e dobishme e digjitalizimit është përmirësimi i qasjes dhe i rrethanave për t'i ruajtur regjistrimet origjinale që për rrjedhojë do të trajtohen më pak përmes duarve/kontaktit fizik. "Përdorimi i surrogatit zvogëlon trajtimin e materialit të vjetër ose të brishtë, duke shpresuar në sigurimin e jetëgjatësisë së origjinalit".⁶

Megjithatë, përfitimet e procesit të digjitalizimit të arkivave janë të shumëfishta, gjithëpërfshirëse dhe gjithaq të prekshme për institucionin arkivor dhe për publikun. "Automatizimi i trashëgimisë digjitale brenda institucioneve historike dhe kulturore mundësoi sistemim më të madh të menaxhimit të koleksioneve dhe proceseve, duke siguruar barazimin e aksesit dhe njohjen e Muzeut dhe të Arkivave".⁷ Digjitalizimi duke lejuar, ndër të tjera, qasjen në distancë nga përdoruesit e njëkohshëm, rrit kështu edhe produktivitetin e institucionit referues.

Më tej, përdorimi i materialeve të digjitalizuara si zëvendësuese të atyre origjinale, përmirëson dhe shton përpjekjet e ruajtjes së pasurisë dokumentare. "Përdorimi i surrogatit me cilësi të lartë ka për qëllim t'i kënaqë nevojat e studiuesve, përndryshe ata duhet të kthehen të konsultohen me origjinalin".⁸ Njëkohësisht, krahas evitimit të gjymtimit të dokumenteve origjinale përmes qasjes së reduktuar në to, kopjet kompjuterike garantojnë në formën e "back-up"-it një trajtë alternative ose rezervë të dokumenteve që përndryshe do të ishin dëmtuar ose integriteti i tyre do të ishte cenuar në mënyrë të parikuperueshme në raste katastrofash, siç janë: zjarret, përmbytjet etj.

⁶ Bernard Reilly, *Clir.org, Collections: Museum Collections On-line*. Shikuar më dt. 02.06.2020 në <https://www.clir.org/pubs/reports/pub88/coll-museum/>.

⁷ Anne R. Kenney dhe Oya Y. Rieger, *Moving theory into practice: digital imaging for libraries and archives* (Mountain View CA: Research Libraries Group, 2000), f. 62.

⁸ Abby Smith, *Why Digitize?*, *Council on Library and Information Resources*, (1999), f. 8.

Një arsye tjetër domethënëse në zgjedhjen për të investuar në zbatimin e projekteve digjitale është promovimi i koleksioneve që institucionet historike dhe kulturore në tërësi zotërojnë, për ta demonstruar rëndësinë e tyre. “Duke krijuar zëvendësues digjitalë të koleksioneve të tyre, institucionet vazhdojnë ta mbështesin nocionin se ka vlerë në materialet që ata strehojnë.”⁹

Në këtë kuptim, digjitalizimi i koleksioneve arkivore jo vetëm se i jep mundësinë DPA-së për menaxhim por, gjithashtu, siguron një rrugë të re për të transmetuar dije dhe kulturë në një rreth gjithnjë e më të gjerë. “Lejimi i një publiku të gjerë për t’i parë zëvendësuesit digjitalë të materialit parësor ofron një shërbim të shkëlqyer dhe një dobishmëri të shtuar për koleksionin”.¹⁰ Po ashtu, derisa teknologjitë e automatizimit kompjuterik vazhdojnë të përparojnë dhe mundësitë e shkëmbimit të informacionit janë bërë të pakufizuara, fuqizohet edhe roli didaktik i DPA-së, si një institucion që strehon koleksione historike shumë të çmuara. “Zgjerimi i aksesit te koleksionet dhe te burimi parësor i informacionit, lehtëson zhvillimin e mundësive të reja arsimore dhe kërkimore”.¹¹

Shtjella koherente në vargun e paragrafëve të mësipërm demonstroi se zgjedhja për ta përdorur kompjuterin dhe teknologjitë e ndërlidhura për t’i digjitalizuar koleksionet nga institucionet arkivore, është e mirëmenduar dhe jo e rastësishme. Në rrethanat teksa ishte ripërmasuar pa kthim veprimtaria e jetës së përditshme të publikut të gjerë, lipsej njohur nevoja për të qenë në korrent me teknologjitë e përditësuar. Ky adaptim i teknologjisë edhe në lëmin e trashëgimisë historike jo vetëm ka ndryshuar mënyrën me të cilën ky institucion ndërvepron me publikun, por edhe me sivëllezërit e tjerë të orientuar nga burimet dhe kërkimet.

II. Sfidat e automatizimit dhe aftësia adaptuese e studiuesve

2.1. Bashkëpunimi, çelës i mbarëvajtjes së projekteve të digjitalizimit

Pikësëpari, bashkëpunimi është një element thelbësor i domosdoshëm për mbarëvajtjen e projekteve të digjitalizimit. Thënë këtë, për konkretizimin e konvertimit digjital, nevojitet që një shumësi “lojtarësh”, siç janë: arkivistët, bibliotekarët, teknikët e skanimit, programuesit, kataloguesit etj., t’i kanalizojnë njohuritë dhe ekspertizat e tyre në drejtim të finalizimit dhe të vijimësisë së suksesshme të automatizimit të të dhënave dhe të përmbajtjeve arkivore. Në rrafshin e zbatueshmërisë, specializimi i personelit dhe burimet financiare shtesë vlerësohen si kostot më të mëdha të hasura në projektet e

⁹ Freda Matassa, *Museum Collections Management* (Facet Publishing, Londër, 2011), f. 32.

¹⁰ Jason Gertz, *Selection for preservation in the digital age: An overview, Library Resources and Technical Services* (2000), f. 99.

¹¹ Horan, *Digitization of Museum and Archival Collections*, f. 15.

digjitalizimit. “Projektet e konvertimit digjital kërkojnë nivele të shtuara të punës që nuk nevojiten në projektet tradicionale të riformatimit. Katalogimi i materialit të ri shton kostot e buxhetit”.¹²

Ndërkaq, në një fushëpamje diametralisht tjetër, pjesëmarrja në projekte të kësaj natyre dhe të këtyre përmasave, lejon zhvillimin profesional të stafit, i cili përfiton aftësi të reja suplementare, pasuron e përditëson dijenitë në fushën e ekspertizës. “Profesionistët që punojnë së bashku duhet të marrin parasysh që në qendër të çdo programi digjital janë përdoruesit dhe koleksionet. Të dyja palët ofrojnë njësi matëse të strukturave të reja”.¹³ Pra, digjitalizimi, ndonëse i kushton kohë institucionit me vlerësime të fizibilitetit dhe trajnimin e punonjësve, siguron “vlerë të shtuar” për materialet dokumentare dhe sjell edhe një frymë bashkëkohore, duke zhvlerësuar “mitin” e burokracisë nëpërmjet zhdërvjelltësimit të ndërveprueshmërisë me publikun.

Kushtueshmëria e projekteve digjitale që faturohen për rinovimin e pajisjeve teknologjike dhe për pajtimin e programeve në terma elektronikë, sugjeron një ekuilibrim të kursimeve afatshkurtra të kostos në hapësirë me kostot afatgjata për ruajtjen e aksesueshmërisë së imazheve digjitale me kalimin e kohës. Burimet digjitale janë asete institucionale në vetvete dhe jo thjesht zëvendësuese të një dokumenti analog. Si të tilla, ato duhet të menaxhohen dhe të mirëmbahen në vazhdimësi. “Fizibiliteti teknik dhe një angazhim afatgjatë ndaj infrastrukturës teknologjike, duhet të vlerësohen përpara se të filloni një projekt të konvertimit digjital. Menaxherët e sistemeve jo vetëm se duhet t’i kuptojnë programet dhe harduerët që ndryshojnë vazhdimisht, por ata tani duhet t’i mësojnë nuancat e arkivistikës dhe të disiplinave të ndërlidhura”.¹⁴

Një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet jetëgjatësia e informacionit digjital, nuk është vetëm përkeqësimi i mjeteve të depozitimit, por problemi i ndryshimit të shpejtë të pajisjeve të ruajtjes. Për dallim nga informacionet analoge, ku përqendrimi është i kufizuar për ruajtjen e dokumentit fizik, duhet bërë një hap konceptual për ta ruajtur informacionin në epokën digjitale. Është e udhës që kopje të shumta të dosjeve digjitale të ruhen në medime të ndryshme. Zgjidhja më e sigurt për ruajtjen e këtyre “depove” përfshin aplikacionin “cloud”, ku dosjet e ruajtura “banojnë” në një server aktiv, por të largët dhe “rifreskohen” rregullisht. “Ju, gjithashtu,

¹² John W. Hoopes, *Wibe The future of the past: Archaeology and anthropology on the World Web, Archives and Museum Informatics* (1997), f. 89.

¹³ Nur Atiqah Mohd Azim, Saiful Farik Mat Yatin, Rayson Clinsmund Anak Jensonray, Syahirah Ayub Mansor, *Digitization of Records and Archives: Issues and Concerns, International Journal of Academic Research in Business and Social Sciences* (2018), f. 176.

¹⁴ Paula de Stefano, *Selection for Digital Conversion in Academic Libraries, College & Research Libraries* (2000), f. 63.

mund të dëshironi të bëni kopje rezervë në DVD/CD apo USB. Këto zgjidhje janë ekonomike, por jo ideale për ruajtje afatgjatë. Mbani mend se DVD/CD-të kanë një afat të kufizuar (më pak se 10 vjet); disqet duhet të kontrollohen rregullisht dhe imazhet të migrohen sipas nevojës”.¹⁵

Ndryshimi i vazhdueshëm i pajisjeve dhe i softuerëve kërkon vigjilencë dhe aftësi përshtatëse të personelit ndaj risive të vazhdueshme që sakaq janë të dala mode në një hark kohor shumë të shkurtër. Baraspesha duhet të jetë pjesë organike edhe gjatë vendimmarrjes në rastet kur përzgjidhen koleksionet arkivore që duhen digjitalizuar, pasi që institucionit i volitet të ndërmarrë një analizë kostoje dhe përfitimesh kundrejt synimeve të përcaktuara në planin afatmesëm dhe afatgjatë, si edhe në raport me interesat dhe përfitimet e studiuësit. “Përzgjedhja për konvertim digjital vazhdon të funksionojë nën premisat e aksesit dhe lehtësisë së përdorimit, në vend të përkeqësimit fizik. Projektet e shndërrimit digjital duhet të jenë më shumë të orientuara drejt qëllimit sesa drejt teknologjisë”.¹⁶

2.2. Afrueshmëria e DPA-së me rininë dhe “teknikofobia” e përmbysur te të moshuarit

Në këtë ndalesë të fundit të “itinerarit” që përshkuam, të prirë nga synimi për t’i analizuar përparësitë që kanë mundur dhe sfidat që kanë shpalosur risitë digjitale, trajtesa do të marrë një kah empirik mbi aftësinë adaptuese të qytetarëve/studiuësve në rrafshin e shfrytëzimit të dokumentacionit. Gjeneralitetet e një tërësie prej 2 000 studiuësish të regjistruar në Sallën e Studimit të DPA-së që prej janarit të vitit 2019 janë akumuluar dhe elaboruar në mënyrë konfidenciale, duke pasur si qëllim që përmes konvertimit të shifrave në përqindje, të mund të evidentohet rata e frekuentimit të secilës prej tri kategorive moshore mbizotëruese: 18-35 vjeç (grupmosha e të rinjve), 36-59 vjeç (grupmosha e mesme) dhe 60-90 vjeç (grupmosha e të moshuarve).

Nga hulumtimi i bazës së të dhënave ka rezultuar (shih diagramin nr. 1) se kategoria e studiuësve që zë peshën më të madhe në historikun e vizitave fizike apo virtuale në Sallën e Studimit të DPA-së, i përket grupmoshës së mesme (783 studiuës), që lë pas me një diferencë shumë të ngushtë të rinjtë (684 studiuës), ndjekur nga të moshuarit (536 studiuës) që, megjithatë, mbeten në një nivel frekuentimi të konsiderueshëm. Nisur nga kjo “radiografi”, faktohet se të moshuarit, që shpeshherë stigmatizohen për paaftësi përshtatjeje me ritmet dinamike të automatizimit, nuk “vuajnë” nga kurrfarë “teknikofobie” në aksesimin e pasurive arkivore. Digjitalizimi si forma më bashkëkohore e qasjes në dokumentacione është “përqafuar”

¹⁵ De Stefano, *Selection for Digital Conversion in Academic Libraries*, f. 65.

¹⁶ Azim, Yatin, Jensonray, Mansor, *Digitization of Records and Archives: Issues and Concerns*, f. 178.

gjerësisht edhe nga breznitë e shkuara në moshë, mes të tjerash, falë efikasitetit në përdorimin e sistemit kompjuterik të Sallës së Studimit, si dhe procedurës së kollajtë të porositjes së materialeve arkivore.

Të dhënat plazmojnë edhe afrueshmërinë e DPA-së me rininë, studiuesit nga radhët e së cilës paraqesin interes të shtuar, që përkthehet në pjesëmarrje në vlera shumë të kënaqshme në modalitetet e reja kërkimore. “Interneti do të bëhet agora për kërkime, mësimdhënie, botime dhe komunikim. Shumë veta, veçanërisht brezi i ri, konsultohen me bibliotekat dhe arkivat si destinacion i fundit. Kjo duhet të ndryshojë nëse këto subjekte dëshirojnë ta vazhdojnë operimin si ofrues të informacionit parësor”.¹⁷

Përdorimi i karakterit edukativ i materialeve arkivore të digjitalizuara komunikon rëndësinë e së kaluarës dhe ndihmon në davaritjen e idesë klishe për institucionet arkivore, që në formën e tyre klasike në epokën paraelektronike, cilësoheshin rëndomë si “të paarrtshme/të paaksesueshme”. “Prania e shtuar e publikut dhe mundësitë e reja të mësimi gjithëpërfshirës kanë ndihmuar këto institucione t’i zgjerojnë vizitat përmes përdorimit të faqeve të internetit, duke arrirë një audiencë virtuale”.¹⁸

Për të ardhmen treguesit e mësipërm indikojnë që DPA-ja duhet të vazhdojë të përfshijë në metodologjinë e saj operacionale teknologji të reja dhe të përparuara, me qëllim që të tërheqë një audiencë të re dhe bashkëkohore, për ta forcuar kërkimin shkencor, duke i mbajtur të dhënat e përditësuara dhe duke përçuar on-line dokumentacionet. Përkundër një perceptimi të përgjithshëm që parasheh rënien e lirë të interesit për historinë dhe të shkuarën në tërësi, gjasat janë që duke përdorur teknologji përparimtare, Salla e Studimit e DPA-së do të vijojë të frekuentohet, qoftë fizikisht apo virtualisht, sikurse u dëshmuua nga boshti empirik i këtij punimi, në pajtueshmëri me parapëlqimet dhe kërkesat e publikut, duke rezonuar kështu edhe me tempin e automatizimit.




Fig. 1. Frekuentimi në sallën e studimit

¹⁷ Smith, *Why Digitize?*, f. 10.

¹⁸ Po aty f. 10.

Përfundim

Digjitalizimi ka fuqizuar ndërveprueshmërinë mes publikut të gjerë dhe DPA-së në sajë të instalimit të një metodologjie të re dhe bashkëkohore në shfrytëzimin dhe administrimin e pasurisë arkivore. Në këtë kuptim përfitimet e procesit të digjitalizimit janë të shumëfishta, gjithëpërfshirëse dhe gjithaq të prekshme për të dyja palët ndërkëmbyese. Arkivimi digjital mundëson që informacionet të arrihen kudo, në çdo kohë dhe nga kushdo që ka nevojë për to, duke rritur kështu edhe produktivitetin e institucionit referues përmes qasjes në distancë.

Zbatimi i projektit të digjitalizimit të Sallës së Studimit, që daton në janar të vitit 2019, ka prezantuar një formë novatore të hulumtimit në dokumentacione, të adaptuar nga të gjitha grupmoshat e studiuesve. Nga hulumtimi i bazës së të dhënave me gjeneralitetet e një tërësie prej rreth 2000 studiuesish, ka rezultuar se kategoria që zë peshën më të madhe në historikun e vizitave fizike apo virtuale në Sallën e Studimit të DPA-së, i përket grupmoshës së mesme, që lë pas me një diferencë shumë të ngushtë të rinjtë, ndjekur nga të moshuarit që, megjithatë, mbeten në një nivel frekuentimi të konsiderueshëm.

Nisur nga kjo “gjedhe”, faktohet se digjitalizimi si forma më bashkëkohore e qasjes në dokumentacione, është mirëpritur gjerësisht edhe nga breznitë e shkuara në moshë, mes të tjerash, falë efikasitetit për përdorimin e sistemit kompjuterik të Sallës së Studimit, si dhe procedurës së kollajtë të porositjes së materialeve arkivore. Të dhënat plazmojnë gjithashtu edhe afrueshmërinë e DPA-së me rininë, studiuesit nga radhët e së cilës paraqesin interes të shtuar, që përkthehet në pjesëmarrje në vlera shumë të kënaqshme në modalitetet e reja kërkimore.

Vlen të theksohet se përdorimi i materialeve të digjitalizuara përmirëson dhe shton përpjekjet e ruajtjes së pasurisë dokumentare. Kopjet kompjuterike optimizojnë jetëgjatësinë dhe pacenueshmërinë e integritetit fizik të materialeve, si dhe shërbejnë në formën e “back-up”-it për rimëkëmbjen e tyre në raste katastrofash. Më tej, implementimi i projekteve digjitale favorizon promovimin e koleksioneve arkivore të rëndësishme. Mbi këtë premisë, DPA-së i sigurohet një rrugë e re për të transmetuar dije dhe kulturë në një rreth gjithnjë e më të gjerë studiuesish.

Megjithatë, mbarëvajtja e pilotimit të digjitalizimit përcaktohet nga bashkëpunimi i një shumësie aktorësh. Nevojitet që arkivistët, bibliotekarët, teknikët e skanimit, programuesit, kataloguesit etj., t'i kanalizojnë njohuritë dhe ekspertizat e tyre në drejtim të finalizimit dhe të vijimësisë së suksesshme të automatizimit të të dhënave dhe të përmbajtjeve arkivore. Kjo veprimtari kapilare është ndihmesë e domosdoshme për përballimin e një prej sfidave më të mëdha me të cilat përballet jetëgjatësia e informacionit digjital: ndryshimi i vazhdueshëm i pajisjeve dhe i softuerëve. Sprova në fjalë mund të kapërcehet vetëm me vigjilencë dhe aftësi përshtatëse të

personelit ndaj risive të vazhdueshme, që sakaq janë të dala mode në një hark kohor shumë të shkurtër.

Bibliografi:

- Azim, N. A. M., Yatin, S. F. M., Jensonray, R. C. A., dhe Ayub Mansor, S. *Digitization of Records and Archives: Issues and Concerns. International Journal of Academic Research in Business and Social Sciences* (2018): 170-178
- Beamsley, Teresa. *Securing digital image assets in museums and libraries: A risk management approach. Library Trends* (1999): 358-78
- De Stefano, Paula. *Selection for Digital Conversion in Academic Libraries. College & Research Libraries* (2000): 58-67
- Edward P. Alexander dhe Mary Alexander. *Museum in Motion*. New York: Alta Mira Press, 2008
- Gertz, Jason. *Selection for preservation in the digital age: An overview. Library Resources and Technical Services* (2000): 97-104
- Hoopes, John W. *Wibe The future of the past: Archaeology and anthropology on the World Web. Archives and Museum Informatics* (1997): 87-105
- Horan, Genevieve A. *Digital Heritage: Digitization of Museum and Archival Collections. Research papers* (2013): 1-39
- Kenney, Anne R. dhe Rieger, Oya Y. *Moving theory into practice: digital imaging for libraries and archives*. Mountain View CA: Research Libraries Group (2000)
- Matassa, Freda. *Museum Collections Management*. London: Facet Publishing, 2011
- Reilly, Bernard. "Clir.org". Collections: Museum Collections Online. Konsultuar më dt. 02/06/2020 nga <https://www.clir.org/pubs/reports/pub88/coll-museum/>
- Smith, Abby. *Why Digitize? Council on Library and Information Resources*, (1999): 1-13
- UNESCO. *Concept of Digital Heritage*. Konsultuar më dt. 02/06/2020 nga <http://www.unesco.org/new/en/communication-and-information/access-to-knowledge/preservation-of-documentary-heritage/digital-heritage/concept-of-digital-heritage/>

